

## **Udhëzues për Organizatat e Shoqërisë Civile**

### **Mbi Programin**

Programi i Granteve të Vogla ka filluar së pari në vitin 1983, ndërsa pas decentralizimit të tij është shtrirë edhe në Shqipëri prej tre vjetësh. Programi i Granteve të Vogla përqëndrohet në *angazhimin qytetar<sup>1</sup> dhe fuqizimin e grupeve të mënjanuara dhe në rrezik të popullsisë<sup>2</sup>*. Qëllimi i tij është të mbështesë fuqizimin e angazhimit qytetar për të patur autorësi mbi proceset e zhvillimit, duke i bërë këto procese më gjithëpërfshirëse dhe me shanse të barabarta për të gjithë.

Në elementët kryesorë të fuqizimit të grupeve të rrezikuara përfshihen: mundësimi i informacionit, mundësimi i lidhjeve të këtyre grupeve të rrezikuara të popullsisë me organizata/institucione të tjera, kapaciteti për të influencuar opinionin publik dhe për të negociuar me pushtetin qendror dhe atë lokal, ekzistenca e institucioneve të besueshme qendrore dhe lokale, prania e një politike të aftë dhe kuadri ligjor të duhur mbi angazhimin qytetar. Organizatat e shoqërisë civile ushtrojnë një rol të rëndësishëm në përfshirjen e qytetarëve në luftën kundër varfërisë dhe përjashtimit të tyre nga proceset e zhvillimit. Pra, ata që përfitojnë nga Grantet e Vogla janë organizatat e shoqërisë civile të përfshira në nisma për fuqizimin e grupeve dhe individëve që ndjehen të mënjanuar dhe të përjashtuar nga jeta publike.

#### **Angazhimi qytetar mund...**

- **Të nxisë konsensusin publik dhe përgjegjësinë lokale** për reforma dhe strategjinë e zhvillimit social-ekonomik të vendit dhe pakësimit të varfërisë duke krijuar rrjete të shpërndarjes së njohurive e eksperiencave, kushte për konsensus e marrëveshje, duke nxitur bashkëpunimin e sektorit privat me atë publik, apo uljen e tensioneve e nxitjen e pajtimeve;
- **Të bëjë të dëgjohen shqetësimet e aktorëve primarë dhe sekondarë**, vecanërisht popullsisë së varfër dhe të mënjanuar, dhe të ndihmojë që ky zë të përfshihet në programet dhe politikat vendimmarrëse;

<sup>1</sup> Angazhimi qytetar është procesi nëpërmjet të cilit organizatat e shoqërisë civile angazhohen aktivisht në marrëdhënie dhe veprimtari me shtetin dhe aktorë të tjerë të përfshirë me problemet e zhvillimit, për trajtimin e çështjeve me interes të përgjithshëm shoqëror.

<sup>2</sup> Grupe të mënjanuara apo në rrezik përfshijnë femijë, të rinj, gra, pleq të braktisur apo pa përkrahje, grupe të varfra të popullsisë që jetojnë në zona të prapambetura, ose me rrezik të lartë mjedisor, grupe të zhvendosura të popullsisë, etj.

- **Të forcojë ndikimin e programeve të zhvillimit** duke ofruar njohuritë lokale, identifikuar rreziqet e mundshme, saktësuar nevojën për asistencë dhe të sigurojë që kjo asistencë të mbërrijë tek komuniteti në nevojë;
- **Të sjellë ide dhe zgjidhje novatore për sfidat e zhvillimit** në nivel lokal dhe qëndror;
- **Të ofrojë ekspertizë profesionale dhe të rrisë kapacitetet** për shpërndarje efektive të shërbimeve, sidomos atje ku sektori publik është i dobët; dhe
- **Të përmirësojë transparencën publike dhe përgjegjshmërinë** në programet e zhvillimit duke kontribuar në krijimin e një mjedisi të qeverisjes së mirë.

## Para se të aplikoni

Programi i Granteve të Vogla mund të financojë vetëm një pjesë të vogël të kërkesave që i paraqiten. Shumë nga këto kërkesa nuk mund të merren parasysh, jo sepse janë të pajustificuara, por sepse nuk i plotësojnë kriteret ose qëllimet e Programit të Granteve të Vogla. Aktiviteti i propozuar mund edhe të plotësojë kriteret ose qëllimin e programit, por kërkesa për financim tejkalon fondet e disponueshme. Para se të aplikoni, fillimisht lexoni Udhëzuesin për të parë nëse propozimi juaj përmbush kërkesat.

## Kush mund të aplikojë?

- Cdo organizatë vendase e shoqërisë civile që punon për problemet e zhvillimit mund të aplikojë për Grantet e Vogla;
- Organizatat e shoqërisë civile duhet të jenë në pozita të shëndosha, të kenë shënuar arritje gjatë aktivitetit të tyre në komunitet dhe të kenë besueshmëri financiare;
- Do t'u jepet përparësi organizatave të cilat nuk janë mbështetur nga ky Program (i centralizuar dhe decentralizuar) gjatë viteve të mëparshme.

## Ç'loj aktivitesh do të mbështeten?

Programi i Granteve të Vogla mbështet aktivitete të lidhura me *angazhimin qytetar për fuqizimin e grupeve të mënjanuara dhe në rrezik. Strategjia kombëtare për zhvillim social-ekonomik krijon mundësi për një pjesëmarrje më të madhe të të varfërve në programet e zhvillimit. Kjo kërkon një dialog dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjitha palët e interesuara. Programi i Granteve të Vogla dëshiron të kontribuojë në forcimin e këtij bashkëveprimi me qëllim përfshirjen e pikëpamjeve të gjithësecilit, përfshirë grupet e mënjanuara të popullsisë.*

Projektet e paraqitura në kuadrin e Granteve të Vogla duhet të trajtojnë:

- Mundësimin e informacionit dhe lidhjeve të grupeve të rrezikuara të popullsisë me organizata/institucione të tjera;
- Ndërgjegjësimin e opinionit publik mbi nevojat e këtyre shtresave të mënjanuara;
- Rritjen e kapacitetit të këtyre grupeve për të influencuar opinionin publik dhe për të negociuar me pushtetin qendror dhe atë vendor;
- Nxitjen e integritit shoqëror të grupeve të përjashtuara dhe të rrezikuara;
- Nxitjen e proceseve pjesëmarrëse të këtyre grupeve në vendimmarrje;
- Rishikimin e kuadrit ligjor mbi angazhimin qytetar dhe fuqizimin e grupeve të menjanuara. Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor të duhur mbi angazhimin qytetar.

Aktivitetet duhet të:

- Promovojnë dialogun dhe shpërndarjen e informacionit;
- Përmirësojnë partneritetin me faktorët kyc në mbështetje të procesit të zhvillimit. Faktorët kyc mund të jenë agjenci qeveritare, organizata të shoqërisë civile, fondacione dhe sektori privat;

Aktivitetet mund të përfshijnë, (por jo të kufizohen vetëm me to), seminare, fushata ndërgjegjësimi/debate, krijim forumesh/rrjetesh, publikime dhe materiale audio-vizuale, ose aktivitete të tjera novatore për forcimin e rrjetit të organizatave komunitare, për të cilat, zakonisht, organizatat e vogla kanë vështirësi t'i përballojnë me buxhetin e tyre të zakonshëm. Këto aktivitete duhet të nxisin përfshirjen e të varfërve në procesin e reformave dhe strategjisë kombëtare për zhvillim social-ekonomik në nivel lokal me mundësinë e replikimit në projekte dhe zona të tjera të vendit. Aktiviteti duhet të përfundojë brenda një viti nga data e dhënies së grantit.

### Ç'lloj aktivitesh nuk do të mbështeten?

Grantet e Vogla nuk mund të financojnë: programe kërkimore, programe trainimi akademike, projekte operative, mbështetje të vazhdueshme institucionale (p.sh. pajisje), bursa, programe studimi, aplikime individuale, ose të enteve të palegalizuara. Veprimtaritë e propozuara nuk duhet të konkurrojnë ose zëvendësojnë instrumentat e Bankës Botërore; ato duhet të dallojnë qartë nga programi normal i Bankës.

Në klasifikimin e mëposhtëm, janë përfshirë veprimtari ose subjekte, të cilat nuk mund të mbështeten nga Programi i Granteve të Vogla.

- Pajisje mjekësore, si pajisje për spitale, aparate degjimi, paterica;
- Pajisje kompjuterike dhe instalimi i tyre;
- Shpenzime të llojit: qira, mirëmbajtje, ose furnizim me materiale zyre jashtë projekt-propozimit;

- Seminare për trajnimin e aftësive në punë; sensibilizimin ndaj SIDA-s; duhanit;
- Forcimi i kapacitetit të OJQ-ve që ato të bëhen konsulente/ të punësuar pranë projekteve të Bankës;
- Plotësimi i nevojave bazë, si furnizimi me ujë, ngrohje, ushqim;
- Ndërtimi i faciliteteve sanitare ose bibliotekave;
- Hapja e vendeve të punës ose punësime;
- Fushata për kontrollin e sëmundjeve;
- Ndihma në ushqim;
- Paga të plota jashtë projekt-propozimit, p.sh, për drejtorin e OJQ-së;
- Projekte në infrastrukturë, si ujësjellës, puse, etj..

## Madhësia e grantit

Për Vitin Fiskal 2003, Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë i është akorduar shuma e përgjithshme prej 45,000\$ për Programin e Granteve të Vogla. Bazuar mbi këtë shumë totale, shumica e granteve do të jenë nga 3,000 deri në 5,000 \$. Shuma maksimale mund të arrijë shifrën 7,000\$ për organizata me përvojë mbi trevjecare. Programi i Granteve të Vogla rrallë mund të financojë mbi gjysmën e buxhetit të parashikuar për një aktivitet, duke preferuar të bashkëfinancojë me donatorë të tjerë. Për këtë arsye do t'ju sugjeronim që të aplikoni edhe në donatorë të tjerë me programe të ngjashme për shoqerine civile për burime të tjera financimi. Organizatave aplikante u kërkohet të shpjegojnë se si granti nga Banka Botërore mund të ndihmojë për marrjen e fondeve plotësuese nga donatorë të tjerë.

## Si aplikohet për një grant?

Administrimi i Granteve të Vogla i ka kaluar Zyrave Lokale të Bankës Botërore. Programi i Granteve të Vogla është i përvitshëm. Jo të gjitha zyrat lokale të Bankës Botërore administrojnë këtë program. Organizatat aplikante duhet të paraqesin propozime për projekte që do të bëhen katër deri gjashtë muaj pas aplikimit.

Udhëzuesi dhe forma e aplikimit mund të tërhiqen pranë zyrës së Bankës Botërore në Tiranë gjatë gjithë muajit janar. Ato mund t'i gjeni edhe në faqen e internetit të zyrës së Bankës Botërore: [www.worldbank.org.al](http://www.worldbank.org.al). Aplikimi bëhet në shqip dhe dërgohet pranë zyrës së Bankës Botërore në Tiranë në adresën:

**Ana Gjokutaj, Koordinatorë e PGV**  
**Tel. 24 05 87/88/89**  
**e-mail: [agjokutaj@worldbank.org](mailto:agjokutaj@worldbank.org)**  
**Zyra e Bankës Botërore**  
**Rruga: Dëshmorët e 4 shkurtit, Tiranë**

Aplikantët këshillohen të lexojnë me vëmendje Udhëzuesin dhe formularin e aplikimit para dorëzimit të projekt-propozimit.

## Si vlerësohen aplikimet?

Marrja e vendimeve për Grantet e Vogla bëhet vetëm një herë në vit. Grantet aprovohen nga Komisioni i Granteve të Vogla, brenda Zyrës Lokale të Bankës Botërore. Programi i Granteve të Vogla merr parasysh të gjitha propozimet. Rishikimi i propozimeve mund të zgjasë deri në 4 muaj. Komisioni i Programit të Granteve të Vogla i vlerëson aplikimet në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- A do të promovojë granti dialog të frutshëm dhe shpërndarje të informacionit me objektiv *angazhimin qytetar për fuqizimin e grupeve të mënjanuara dhe në rrezik?*
- A është kërkuar granti për një aktivitet të vetëm?
- A përfundon aktiviteti brenda një viti?
- A shërben granti për të gjeneruar fonde shtesë nga donatorë të tjerë?
- A është grantkërkuesi organizatë vendase?

## Cilat grante kanë prioritet?

Ndërsa gjithë aplikimet që përmbushin kriteret e mësipërme janë të pranueshme për financim, Komisioni i PGV u jep prioritet:

- Aktiviteteve që nxisin lidhje aktive dhe bashkëpunim midis grupeve të ndryshme si komuniteteve, organizatave komunitare, OJQ-ve lokale, pushtetit lokal, sektorit privat etj.;
- Aktiviteteve që jo vetëm identifikojnë problemin, por ofrojnë zgjidhjen për të;
- Aplikimeve që merren 3-4 muaj para aktivitetit të propozuar dhe dëshmojnë se financimi i Bankës Botërore ndihmon në gjenerimin e financimeve shtesë nga donatorë të tjerë;
- Aplikimeve të organizatave që nuk janë kontraktuar më parë nga Banka në ndonjë nga projektet e financuara nga ajo.